



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL

Nr.52105-01393-00-2012 i Regj.Themeltar  
Nr.00-2015-598 i Vendimit (40)

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

<b>Edmond Islamaj</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Artan Zeneli</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ardian Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Guxim Zenelaj</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Admir Thanza</b>	<b>Anëtar</b>

në seancën gjyqësore, të datës 11.03.2015, mori në shqyrtim çështjen penale Nr. 52105-01393-00-2012, që i përket:

**KËRKUES:** **Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër,**  
*përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça.*

**KUNDËR:** **Ardian NARKAJ.**

**AKUZUAR:** *Se ka kryer veprën penale të “Vrasjes në rrethana cilësuese” dhe “Prodhimit e mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”, parashikuar nga nenet 79/dh dhe 278/2 i K. Penal.*

**Gjekë NARKAJ.**

**Ilir THERÇAJ.**

**AKUZUAR:** *Se kanë kryer veprën penale të “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” dhe “Prodhimit e mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit”, parashikuar nga nenet 79/dh dhe 278/2 i K. Penal.*

-----

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin Nr. 222, datë 21.05.2009 ka vendosur:**

“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Narkaj për veprën penale të “*Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese kundër dy ose më shumë personave*”, parashikuar nga neni 79/dh i K. Penal dhe dënimin e tij më 24 (njëzet e katër) vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Narkaj për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij më 2 (dy) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal për bashkimin e dënimeve përfundimisht dënimin e të pandehurit Ardian Narkaj me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulët 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ardian Narkaj me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit fillon nga data 08.05.2008 kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Narkaj për veprën penale të “*Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës*”, parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij më 2 (dy) vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Narkaj për veprën penale të “*Armëmbajtjes pa leje*”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij më 1 (një) vit burgim.

Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal për bashkimin e dënimeve përfundimisht dënimin e të pandehurit Gjekë Narkaj me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) burgim.

Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulët 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Gjekë Narkaj me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Gjekë Narkaj fillon nga data 09.05.2008 kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Therçaj për veprën penale të “*Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës*”, parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Therçaj për veprën penale të “*Armëmbajtjes pa leje*”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij më 1 (një) vit burgim.

Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal për bashkimin e dënimeve përfundimisht dënimin e të pandehurit Ilir Therçaj me 2 (dy) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulët 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ilir Therçaj me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Ilir Therçaj fillon nga dita kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

Xhupi fëshfësh, pa mëngë, ngjyrë e zezë, pantallonat ngjyrë blu me stampë US POLO ASSN, bluzë më mëngë të gjata me stampën “Timberland”, kantiere me ngjyrë qumështi etj të sekuestruara me datë 08.05.2008 viktimës Ton Ulaj, ti kthehen familjarëve të tij.

Bluzë sportive me zinxhir me ngjyrë të zezë, me stampë Versace, triko sportive me ngjyrë të gjelbër, tuta të zeza, atlete me ngjyrë të zezë, të sekuestruara më datë 08.05.2008, viktimës Gjergj Shotaj ti kthehen familjarëve të tij.

Provat materiale: pushkë model 56 me Nr. 11267284, 765 fishekë model 56, 15 fishekë model 54, fishekë model 7 30 copë të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 43 datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

Provat materiale pistolete model 54 me Nr. 383 - 46, pistoletë trofe me Nr. 26794, automatik zastava me Nr. 52117, krehe pistolete 1 copë, krehër pistoletë model 57 1 copë, fishek model 54 3 copë, fishek model 56 30 copë, krehër automatiku 2 copë, fishek model 54 4 copë të

magazinuara në Komisarjatin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 47, datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

Provat materiale: pushkë model 56 me Nr. 14146682, fishekë model 56 11 copë, të magazinuara në Komisarjatin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 53, datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

Gëzhojat dhe predhat e gjetura gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes të asgjësohen pasi janë identifikuar dhe armët që i kanë qitur ato.

#### **Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin Nr.19, datë 27.01.2010 ka vendosur:**

Prishjen e vendimit Nr.222, datë 21.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e akteve për rigjykim, po asaj gjykate, por me tjetër trup gjykues.

#### **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin Nr. 248, datë 27.04.2011 ka vendosur:**

“ 1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Ardian Gjeloš Narkaj për kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasit Tonin Ulaj, pasi konform nenit 388/1/e të K. Pr. Penale, vepra është kryer në prani të një shkaku padënueshmërie.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Gjeloš Narkaj për kryerjen e veprës penale të “*Vrasjes në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme*” ndaj shtetasit Gjergj Shotaj, parashikuar nga neni 83 i K. Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Gjeloš Narkaj për kryerjen e veprës penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*” parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 16 muaj burgim.

4. Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal, në bashkim të dënimeve, përfundimisht dënimin e të pandehurit Ardian Narkaj me 4 vjet e 10 muaj burgim.

5. Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga data 08.05.2008, kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

6. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Fran Narkaj për veprën penale të “*Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës*” parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij me 16 muaj burgim.

7. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Fran Narkaj për kryerjen e veprës penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*” parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

8. Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal, në bashkim të dënimeve. Përfundimisht dënimin e të pandehurit Gjekë Narkaj me 1 vit e 8 muaj burgim.

9. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Zef Therçaj për veprën penale të “*Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës*” parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.

10. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Zef Therçaj për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*” parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim.

11. Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal, në bashkim të dënimeve, përfundimisht dënimin e të pandehurit Ilir Zef Therçaj me 1 vit e 4 muaj burgim.

12. Xhupi feshësh, pa mëngë, ngjyrë e zezë, pantallonat ngjyrë blu me stampë US POLO ASSN, bluzë me mëngë të gjata me stampën “TIMBERLEND”, kanatjere me ngjyrë qumështi etj. Të sekuestruara me datë 08.05.2008 viktimës Ton Ulaj ti kthehen familjarëve të tij.

13. Bluzë sportive me zinxhir me ngjyrë të zezë, me stampë VERSACE, triko sportive me ngjyrë të gjelbër, tuta të zeza. të sekuestruara më datë 08.05.2008 viktimës Gjergj Shotaj t'i kthehen familjarëve të tij.

14. Provat materiale pushke mod. 56 me Nr. 11267284, 765 fishekë mod. 56, 15 fishekë mod. 54, fishekë 30 cope mod. 7, të magazinuara në Komisarlatin e Policisë Shkodër të kalojnë në favor të shtetit.
15. Provat materiale pistolete mod. 54 Nr. NM 383-46, pistoletë trofe me Nr. 26794, automatik Zastava Nr. 52117, krehër pistolete 1 copë, krehër pistolete mod. 57, 1 copë, fishekë mod. 54, 3 copë, mod. 56, 30 copë, krehër automatiku 2 copë, fishekë mod. 54, 4 copë, të magazinuara në Komisarlatin e Policisë Shkodër të kalojnë në favor të shtetit.
16. Provat materiale pushke mod. 56 me Nr. 14146682 dhe 11 fishekë mod. 56 të magazinuara në Komisarlatin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 53 datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.
17. Gëzhojat dhe predhat e gjetura gjatë këqyrjes së vendngjarjes, të asgjësohen.
18. Thika e sekuestruar më datë 08.05.2008, me gjatësi 9.8 mm, ku në anën e djathtë ka të shkruar Made in Japan, t'i kthehet të pandehurit Ardian Narkaj.
19. Pesë granatat e gjetura dhe të sekuestruara në banesën e Ardian Narkaj të kalojnë në favor të shtetit.
20. Dy granata të gjetura dhe të sekuestruara në banesën e shtetasit Kol Vulaj të kalojnë në favor të shtetit.
21. Shpenzimet procedurale në ngarkim të të pandehurve, në raport me veprat penale të deklaruar fajtores për të cilat shpenzimet procedurale janë bërë.

**Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin Nr. 124, datë 20.06.2012 ka vendosur:**

“Lënien në fuqi të vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sa i përket të pandehurit Ilir Zef Therçaj.

Prishjen e vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Gjekë Fran Narkaj, lidhur me akuzën e parashikuar nga neni 301 i K. Penal “*Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës*”.

Lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin Gjekë Fran Narkaj lidhur me cilësimin ligjor të veprës, fajësinë dhe masën e dënimit të caktuar ndaj tij për kryerjen e veprës penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal.

Ndryshimin e vendimit për të pandehurin Ardian Gjekë Narkaj si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Gjelosh Narkaj për kryerjen e veprës penale të “*Vrasjes në rrethana cilësuese*” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79/dh-25 të K. Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin Ardian Gjelosh Narkaj lidhur me cilësimin ligjor të veprës, fajësisë dhe masës së dënimit të caktuar ndaj tij për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal.

Në zbatim të nenit 55 të K. Penal, i pandehuri Ardian Gjelosh Narkaj përfundimisht dënohet me 21 (njëzet e një) vjet burgim. Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij.

**Kundër këtij vendimi, më datë 12.07.2012 ka paraqitur rekurs i gjykuari Ardian Narkaj dhe ka kërkuar:** “*Prishjen e vendimit Nr. 124, datë 20.06.2012, të dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër, lënien në fuqi të vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për pikat, 1, 3, 4, dhe 5 të këtij vendimi për të pandehurin Ardian Narkaj*

*-Ndryshimin e pikës 2 të Vendimit Nr. 248 datë 27.04.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke e deklaruar të pafajshëm të pandehurin Ardian Narkaj për veprën penale të “Vrasjes në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” ndaj shtetasit Gjergj Shotaj.”.*

**Në shkaqet e rekursit veçohen:**

- I pandehuri Ardian Narkaj, nuk ka pasur asnjë shkak për të vrarë viktimat pasi ai është marrë direkt nga rruga, ku ai po kthehej me babain e vet dhe nusen e tij nga Qendra e fshatit Bajzë, të cilët kishin qenë, për të blerë truall dhe nga ai moment që është takuar me dy viktimat, ato (viktimat) nuk e kanë ndarë asnjë sekond, për tu shkëputur prej tyre, për të gjetur armë apo sende të tjera si dhe për të njoftuar persona të tjerë me qëllim qoftë edhe për tu mbrojtur prej tyre.
- Ai nuk ka pasur asnjëherë konflikt me viktimat e për rrjedhojë nuk ishte i përgatitur dhe nuk dinte se mund ta merrnin forcërisht nën kërcënimin e armës dy viktimat për tu ballafaquar me Gjekë Narkaj, me të cilin viktimat Tonin Ulaj ka bërë një debat shumë të ashpër duke e fyer rëndë nga familja të pandehurin Gjekë Narkaj.
- Nga të gjitha provat e paraqitura nga Prokuroria dhe administruara nga Gjykata, nuk rezulton dhe nuk provohet se dy viktimat kanë ofenduar dhe denigruar ose kanosur realisht duke i treguar armen të pandehurit Ardian. I vetmi debat që ka pasur Ardiani me dy viktimat ka qenë se sipas tyre u kishte thënë Gjeka se unë jam spiun dhe i spiunojë në polici.
- I pandehuri Ardian Narkaj është marrë nga viktimat Tonin Ulaj nga shtëpia e pandehurit Gjek Narkaj me qëllim për të takuar Gjergj Shotën dhe për tu ballafaquar përsëri me Gjek Narkaj. Por në asnjë rast nuk provohet që Ardiani të jetë shkëputur prej dy viktimave me qëllim t'u armatosur apo qoftë për të njoftuar dhe familjarët e tij.
- I pandehuri Ardian Narkaj në deklaratimet e bërë para Gjykatës, ka dhënë hollësi mbi vrasjen e dy viktimave Tonin Ukaj dhe Gjergj Shotaj për të cilin deklarimi ka qenë korrekt dhe bindës, pasi këtë fakt të deklaruar nga i pandehuri Ardian e provojnë e plagët shpuesë të dy viktimave të cilat kanë sjellë dhe vdekjen e tyre. Pasi ato janë në drejtime të ndryshme para, anash, pas dhe në ije në pozicione të ndryshme dhe distanca të ndryshme. Çka provon më së miri se këto janë gjuajturi nga Gjek Narkaj në një distancë për të cilin sipas tij kishte zënë prite, pasi në rastin konkret Gjeka ishte personi më i denigruar dhe kërcënuar në shtëpinë të tij.
- Konflikti në mes të pandehurit Gjek Narkaj dhe dy viktimave, interesimi i Gjeks për të fshehur armët e krimit, mos njoftimi nga ana e pandehurit Gjek Narkaj, të familjarëve të Ardian Narkaj, se atë e kishin marrë dy viktimat, prania e të pandehurit Gjek Narkaj në kohë rekord në vendin e ngjarjes bashkë me djalin e tij, provojnë më së miri edhe deklaratimet e mia (Ardiani) të bërë në seancë gjyqësore përpara Gjykatës. Gjithashtu gjatë gjykimeve është e provuar se e vetmja armë që kishte në përdorim Ardian Narkaj ishte një thikë të cilën e kishte pasur në derën e makinës së tij të cilën e ka përdorur gjatë kohës që ai ishte i plagosur nga viktimat apo dhe plumbat e ardhura nga prita e Gjek Narkës. Me të drejtë logjikisht vjen dhe përgjigja pse i pandehuri Ardian Narkaj duhet të përdorte thikën në një kohë sipas Gjykatës së Apelit ai ka përdorur armët e gjetura në vendngjarje për vrasjen e dy viktimave.
- Edhe debatet e zhvilluara nga viktimat nuk kanë qenë në mes të Ardian Narkajt dhe viktimave, por ky debat ka qenë në mes të pandehurit Gjek Narkaj dhe dy viktimave për të cilën me njërin prej tyre është grindur dhe e kanë fyer të pandehurin Gjek Narkaj.

## KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Edmond Islamaj, prokurorin Arqilea Koça i cili kërkoi prishjen e vendimit Nr. 124, datë 20.06.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e akteve për rigjykim në po atë gjykatë, mbrojtësin e zgjedhur nga i pandehuri av. Arben Keta që kërkoi prishjen e vendimit Nr. 124, datë 20.06.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Shkodër për pikat 1,2,3,4 dhe 5 të këtij vendimi për të pandehurin Ardian Narkaj. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke e deklaruar të pafajshëm të pandehurin Ardian Narkaj, për veprën penale të “Vrasjes në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” ndaj shtetasit Gjergj Shotaj, parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal, dhe pasi analizoi dhe diskutoi çështjen në tërësi;

## V Ë R E N

Se vendimi Nr.124, datë 20.06.2012 i Gjykatës së Apelit Shkodër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material e procedural penal e si i tillë duhet të priset dhe çështja të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

### A. RRETHANAT E ÇËSHTJES.

Më datë 07.05.2008, rreth orës 20.00, i gjykuari Ardian Narkaj së bashku me babanë dhe bashkëshorten e tij kanë shkuar në qendër të fshatit Bratosh për të blerë ushqime me makinën e tij. Pasi kanë blerë ushqimet, i gjykuari është ndaluar nga ana e shtetasit Tonin Ulaj, i cili i ka thënë se perse nuk i binte borisë, kur afrohej në qendër të fshatit, pasi ai (Ardiani) e dinte se Toni kërkohej nga policia. Më pas, debati mes tyre është acaruar dhe shtetasi Toni e ka kapur të gjykuarin Ardianin duke e futur nga pas lokalit dhe duke i thënë se perse na spiunon në polici. I gjykuari Ardian e ka mohuar një gjë të tillë dhe në këtë moment shtetasi Toni i ka thënë që të hipte në makinë se do të shkonin tek shtetasi Gjergj Narkaj për ta sqaruar këtë punë.

Babai i të gjykuarit Ardian dhe gruaja e tij kanë shkuar në shtëpi, ndërsa i gjykuari Ardian dhe shtetasi Toni kanë shkuar në shtëpinë e shtetasit Gjek Narkaj. Aty kanë debatuar dhe Toni i ka thënë të gjykuarit Gjekë “se kush të ka thënë ty se Ardiani është spiun”. I gjykuari Gjekë është përgjigjur se i kishte thënë Gjergj Shotaj. I revoltuar, shtetasi Toni i ka thënë të gjykuarit Ardian të shkonin e të merrnin Gjergj Shotën e të sqaronin këtë punë. Po ashtu Toni i ka thënë Gjekës që të priste se “do ta sqaronin sonte këtë punë”. Ardiani me Tonin kanë marrë makinën e Ardianit dhe kanë shkuar të marrin Gjergj Shotën, i cili i priste tek shkolla e Bratoshit. Pasi janë takuar, ata kanë shkuar tek lokali i shtetasit Bardhok Narkaj, kanë pirë pije alkoolike dhe janë nisur përsëri për të shkuar tek shtëpia e Gjekë Narkaj.

Gjatë rrugës për në shtëpinë e të gjykuarit Gjekë Narkaj, dy viktimat kanë folur disa herë në telefon si dhe kanë debatuar gjatë rrugës. Pasi janë afruar rreth 600 metra shtëpisë se të gjykuarit Gjekë janë dëgjuar të shtëna armë dhe menjëherë viktimat i kanë thënë të gjykuarit Ardian të ndalte makinën, ku Toni ka dalë i pari dhe Gjergji ka dalë më pas, duke kapur Ardianin për qafë. Sipas deklarimit të të gjykuarit Ardian Narkaj, dy viktimat kishin armë zjarri, Gjergj Shotaj kishte një automatik, ndërsa Tonin Ulaj kishte një pistolette dhe një pushkë të gjatë. Pasi kanë zbritur në tokë, dy viktimat kanë filluar të gjuanin në drejtimin nga vinin krismat.

I gjykuari Ardian, i ndodhur në këto rrethana dhe i tmerruar se mund ta vrisnin, pasi kishte marrë dhe një plagë në këmbë, ka marrë një thikë në xhep të derës së makinës dhe ka goditur viktimën Tonin Ulaj, duke i marrë pistoletën që ai kishte në dorë dhe duke qëlluar në drejtim të viktimave. Viktima Gjergj Shotaj, nga plagët që kishte marrë është rrëzuar në tokë, duke marrë me vete edhe të gjykuarin Ardian.

Sipas deklarimeve të të gjykuarit Ardian, gjatë shkëmbimit të zjarrit dy viktimat e mbanin në mes të gjykuarin Ardian për tu mbrojtur nga plumbat që vinin në drejtim të tyre. Po sipas deklarimeve të të gjykuarit Ardian, i gjykuari Gjekë Narkaj ka vazhduar të qëllojë me automatik pa ndërprerje në drejtim të viktimave, në një distance shumë të afërt edhe kur ato ishin të shtirë në tokë.

Pas vrasjes së viktimave, të gjykuarit Ardian Narkaj e Gjekë Narkaj janë larguar për në shtëpinë e të gjykuarit Ardian. Kur kanë mbërritur, aty i gjykuari Ardian i ka dhënë të gjykuarit Gjekë pistoletën me të cilën kishte gjuajtur në drejtim të viktimave dhe ky i fundit, pasi ka shkuar në shtëpi, pistoletën së bashku me automatikun i kishte fshehur nëpërmjet familjareve të tij dhe të gjykuarit Ilir Therçaj. Pas pak kohe, i gjykuari Gjekë ka shkuar përsëri tek shtëpia e të gjykuarit Ardian, është nisur për në spital për të marrë ndihmën e duhur mjekësore të shoqëruar nga shtetasi Ndue Isufi. Gjatë rrugës, të gjykuarit kanë komunikuar me policinë, duke i treguar për ngjarjen, pasi me parë kishin rënë në marrëveshje për të deklaruar se viktimat kishin vrarë njeri tjetrin gjatë gjuajtjeve.

I pyetur për ngjarjen, i gjykuari Gjekë Narkaj tregon pothuajse të njëjtat rrethana që deklaroi dhe i gjykuari Ardian Narkaj, por mohon faktin që ai të jetë bashkautor në vrasjen e dy viktimave. Ai pohon, se pasi është afruar në vendin e ngjarjes, i ka gjetur të vrarë viktimat dhe të plagosur të gjykuarin Ardian Narkaj.

Nga aktet e ekspertimit mjeko-ligjore Nr. 23 dhe 24 date 08.05.2008 rezulton se në trupat e dy viktimave konstatohen plagë të shumta, të shkaktuara nga qitja me armë zjarri jashtë veprimit të faktorëve plotësues të qitjes, ku drejtimi i qitjes është i ndryshëm për plagë të ndryshme. Tek viktima Tonin Ulaj është konstatuar një plagë në bark brenda veprimit të faktorëve plotësues të qitjes dhe një plagë në gjoks, e shkaktuar me mjet prerës shpues. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes janë gjetur gëzhoja të shpërndara në drejtime të ndryshme. Po ashtu, janë gjetur prani të nitriteve e nitrateve në duart e dy viktimave dhe në rrobat e tyre.

## **B. PROCEDURA GJYQËSORE.**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin Nr. 222, datë 21.05.2009 ka vendosur:**

“Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Narkaj për veprën penale të “*Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese kundër dy ose më shumë personave*”, parashikuar nga neni 79/dh i K. Penal dhe dënimin e tij më 24 (njëzet e katër) vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Narkaj për veprën penale të “*Mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij më 2 (dy) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal për bashkimin e dënimeve përfundimisht dënimin e të pandehurit Ardian Narkaj me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ardian Narkaj me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit fillon nga data 08.05.2008 kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Narkaj për veprën penale të “Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij më 2 (dy) vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Narkaj për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij më 1 (një) vit burgim.

Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal për bashkimin e dënimeve përfundimisht dënimin e të pandehurit Gjekë Narkaj me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) burgim.

Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Gjekë Narkaj me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Gjekë Narkaj fillon nga data 09.05.2008 kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Therçaj për veprën penale të “Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Therçaj për veprën penale të “Armëmbajtjes pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij më 1 (një) vit burgim.

Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal për bashkimin e dënimeve përfundimisht dënimin e të pandehurit Ilir Therçaj me 2 (dy) vjet burgim.

Në aplikim të nenit 406/1 të K. Pr. Penale të pandehurit i ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ilir Therçaj me 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Ilir Therçaj fillon nga dita kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

xhupi fëshfësh, pa mëngë, ngjyrë e zezë, pantallonat ngjyrë blu me stampë US POLO ASSN, bluzë më mëngë të gjata me stampën “Timberland”, kantiere me ngjyrë qumështi etj të sekuestruara me datë 08.05.2008 viktimës Ton Ulaj, ti kthehen familjarëve të tij.

Bluzë sportive me zinxhir me ngjyrë të zezë, me stampë Versace, triko sportive me ngjyrë të gjelbër, tuta të zeza, atlete me ngjyrë të zezë, të sekuestruara më datë 08.05.2008, viktimës Gjergj Shotaj ti kthehen familjarëve të tij.

Provat materiale: pushkë model 56 me Nr. 11267284, 765 fishekë model 56, 15 fishekë model 54, fishekë model 7 30 copë të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 43 datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

Provat materiale pistolette model 54 me Nr. 383 - 46, pistolette trofe me Nr. 26794, automatik zastava me Nr. 52117, krehe pistolette 1 copë, krehër pistolette model 57 1 copë, fishek model 54 3 copë, fishek model 56 30 copë, krehër automatiku 2 copë, fishek model 54 4 copë të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 47, datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

Provat materiale: pushkë model 56 me Nr. 14146682, fishekë model 56 11 copë, të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 53, datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

Gëzhojat dhe predhat e gjetura gjatë kqyrjes së vendit të ngjarjes të asgjësohen pasi janë identifikuar dhe armët që i kanë qitur ato.

### **Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin Nr.19, datë 27.01.2010 ka vendosur:**

Prishjen e vendimit Nr.222, datë 21.05.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kthimin e akteve për rigjykim, po asaj gjykate, por me tjetër trup gjykues.



**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin Nr.248, datë 27.04.2011 ka vendosur:**

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Ardian Gjelosh Narkaj për kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasit Tonin Ulaj, pasi konform nenit 388/1/e të K. Pr. Penale, vepra është kryer në prani të një shkaku padënueshmërie.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Gjelosh Narkaj për kryerjen e veprës penale të *“Vrasjes në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”* ndaj shtetasit Gjergj Shotaj, parashikuar nga neni 83 i K. Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim.
3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardian Gjelosh Narkaj për kryerjen e veprës penale të *“Mbajtjes pa leje të armeve luftarake”* parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 16 muaj burgim.
4. Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal, në bashkim të dënimeve, përfundimisht dënimin e të pandehurit Ardian Narkaj me 4 vjet e 10 muaj burgim.
5. Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga data 08.05.2008, kur është bërë ndalimi i tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.
6. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Fran Narkaj për veprën penale të *“Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”* parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij me 16 muaj burgim.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit Gjekë Fran Narkaj për kryerjen e veprës penale të *“Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”* parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.
8. Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal, në bashkim të dënimeve. Përfundimisht dënimin e të pandehurit Gjekë Narkaj me 1 vit e 8 muaj burgim.
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Zef Therçaj për veprën penale të *“Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”* parashikuar nga neni 301 i K. Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burgim.
10. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Zef Therçaj për veprën penale të *“Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”* parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal dhe dënimin e tij me 8 muaj burgim.
11. Në aplikim të nenit 55/1 të K. Penal, në bashkim të dënimeve, përfundimisht dënimin e të pandehurit Ilir Zef Therçaj me 1 vit e 4 muaj burgim.
12. Xhupi feshësh, pa mëngë, ngjyrë e zezë, pantallonat ngjyrë blu me stampë US POLO ASSN, bluzë me mëngë të gjata me stampën *“TIMBERLEND”*, kanatjere me ngjyrë qumështi etj. Të sekuestruara me datë 08.05.2008 viktimës Ton Ulaj ti kthehen familjarëve të tij.
13. Bluzë sportive me zinxhir me ngjyrë të zezë, me stampë VERSACE, triko sportive me ngjyrë të gjelbër, tuta të zeza. te sekuestruara më datë 08.05.2008 viktimës Gjergj Shotaj t'i kthehen familjarëve të tij.
14. Provat materiale pushke mod. 56 me Nr. 11267284, 765 fishekë mod. 56, 15 fishekë mod. 54, fishekë 30 cope mod. 7, të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër të kalojnë në favor të shtetit.
15. Provat materiale pistolete mod.54 Nr. NM 383-46, pistoletë trofe me Nr. 26794, automatik Zastava Nr.52117, krehër pistolete 1 copë, krehër pistolete mod. 57, 1 copë, fisheke mod. 54, 3 copë, mod. 56, 30 copë, krehër automatiku 2 copë, fishekë mod. 54, 4 copë, të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër të kalojnë në favor të shtetit.
16. Provat materiale pushke mod. 56 me Nr. 14146682 dhe 11 fishekë mod. 56 të magazinuara në Komisaratin e Policisë Shkodër me fletë hyrjen Nr. 53 datë 13.08.2008 të kalojnë në favor të shtetit.

17. Gëzhojat dhe predhat e gjetura gjatë këqyrjes së vendngjarjes, të asgjësohen.
- 18.Thika e sekuestruar më datë 08.05,2008, me gjatësi 9.8 mm, ku në anën e djathtë ka të shkruar Made in Japan, t'i kthehet të pandehurit Ardian Narkaj.
- 19.Pesë granatat e gjetura dhe të sekuestruara në banesën e Ardian Narkaj të kalojnë në favor të shtetit.
- 20.Dy granada të gjetura dhe të sekuestruara në banesën e shtetasit Kol Vulaj të kalojnë në favor të shtetit.
- 21.Shpenzimet procedurale në ngarkim të të pandehurve, në raport me veprat penale të deklaruar fajtoresh për të cilat shpenzimet procedurale janë bërë.

**Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin Nr.124, datë 20.06.2012 ka vendosur:**

“Lënien në fuqi të vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sa i përket të pandehurit Ilir Zef Therçaj.

Prishjen e vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Gjekë Fran Narkaj, lidhur me akuzën e parashikuar nga neni 301 i K. Penal “Veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”.

Lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin Gjekë Fran Narkaj lidhur me cilësimin ligjor të veprës, fajësinë dhe masën e dënimit të caktuar ndaj tij për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal.

Ndryshimin e vendimit për të pandehurin Ardjan Gjekë Narkaj si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardjan Gjelosh Narkaj për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana cilësuese” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79/dh-25 të K. Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin Ardjan Gjelosh Narkaj lidhur me cilësimin ligjor të veprës, fajësisë dhe masës së dënimit të caktuar ndaj tij për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal.

Në zbatim të nenit 55 të K. Penal, i pandehuri Ardjan Gjelosh Narkaj përfundimisht dënohet me 21 (njëzet e një) vjet burgim. Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij.

**ARSYETIMI I VENDIMIT TË ANKIMUAR.**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin Nr.248, datë 27.04.2011 ka argumentuar se:**

*“Mbështetur nga vlerësimi në harmoni i provave të cituara me sipër gjykata arrin në përfundimet se:*

*a. I pandehuri Ardian Narkaj nuk ka patur me vete armë zjarri, por gjatë kohës që viktima Gjergj Shotaj ka zbritur në tokë për tu sjellë nga pjesa e pasme e makinës dhe për të shkruar pranë tij për ta marrë dhe nxjerrë jashtë me forcë, ai ka përfituar dhe ka marrë nga xhepi i derës së makinës një thikë, të cilën rastësisht e kishte aty, pasi nisur nga shkalla e dukshme e lartë e manifestimit të irritimit të viktimave, dhe ndalimi i makinës e zbritja në tokë në një vend të pabanuar, e ka bërë të besueshme dhe reale idenë se ata mund ta vrisnin. Në këtë pikë gjykata e gjen bindës arsyetimin e mbrojtjes së këtij të pandehuri, sipas të cilit do të ishte jo logjik dhe i pavend përdorimi i një thike si mjet vetëmbrojtjeje, nëse i pandehuri Ardian Narkaj do të kishte patur me vete armë zjarri. Dëmtimet e shumta me mjet prerës-shpues në xhakaventon e viktimës Tonin Ulaj dhe dy dëmtimet me një mjet të tillë në trupin e tij, e çojnë gjykatën në përfundimin se ai fillimisht është përleshur me këtë shtetas (i cili ishte i armatosur me dy armë) dhe pasi e ka qëlluar me thike në zemër, ky i fundit ka humbur fuqinë dhe për pasojë i pandehuri ka mundur që ti marrë nga duart njërin nga armët e pikërisht*

pistoletën TT (pasi pushkën 10-teshe ai e ka lëshuar më parë në tokë, pasi është gjetur nën trupin e viktimës Gjergj Shotaj.

b. Dy viktimat Tonin Ulaj dhe Gjergj Shotaj kanë qenë të parët të cilët kanë filluar të qëllojnë me armë, fillimisht për të vrarë të pandehurin Ardjan Narkaj e më pas të qëllojnë në mënyrë të pakontrolluar për shkak të errësisës, distancës së afërt, instiktit të vetëmbrojtjes e mbijetesës si dhe pamundësisë fizike dhe mendore për të marrë vendime të kthjellta në lidhje me situatën e krijuar dhe burimet e rrezikut. Konkluzioni se kanë qenë dy viktimat të cilët kanë shtënë të parët, arrihet jo vetëm nga fakti se kanë qenë ata në posedim të armëve të zjarrit, por edhe nga provat e drejtpërdrejta të akteve të ekspertimit kimik të shiritave të natribanit, marrë nga duart e dy viktimave, nga të cilët ka rezultuar se në to kishte prezencë të faktorëve plotësues të qitjes.

c. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes (e pasqyruar me procesverbal, skicë dhe fotografi) qartazi vihet re se përleshja mes të pandehurit Ardian dhe dy viktimave Tonin Ulaj dhe Gjergj Shotaj ka ndodhur në një perimetër të vogël, në një distancë të afërt nga njeri-tjetri (kjo pjesë e arsytimit të gjykatës mund të kuptohet drejtë vetëm duke patur përpara aktet e mësipërme të pasqyrimin të vendit të ngjarjes). Duke marrë në konsideratë se nga të dhënat e tyre teknike pushka 10\_teshe, automatiku Zastava dhe pistoleta TT e nxjerrin gëzhojën në krahun e djathtë të tyre, në kënd 70-90° me drejtimin e qitjes, si dhe faktin se dy të parat mund ta hedhin gëzhojën në një distance nga 1-6 metra, ndërsa pistoleta TT në një distancë nga 1-5 metra (këto në varësi të lartësisë së mbajtjes së armës dhe të sipërfaqes ku bien në tokë), gjykata arrin në përfundimin se dy viktimat kanë qëlluar përballë njeri-tjetrit, ndërsa i pandehuri Ardian, pas marrjes së pistoletës viktimës Tonin, ka qëlluar në drejtim të të dyve (pra në dy drejtime të kundërta). Në lidhje me pushkën 10.teshe, Gjykata mban në konsideratë se për shkak të mungesës së gypit të gazrave dhe presionit që gazrat do ushtronin për të nxjerrë gëzhojën nga foleja e fishekut, distanca e gëzhjës së vetme (pasi tjetra është gjetur në folenë e fishekut) të nxjerrë manualisht nga kjo armë, s'mund të jete me larg se 1-2 metra larg vendit të tërheqjes së shulit të armës.

d. Fakti se fillimisht dy viktimat dhe me pas i pandehuri Ardian kanë qëlluar nga një distance e shkurtër nga objektivi (nga me puqitje deri në 1 metër distancë), provohet jo vetëm nga gjetja e faktorëve plotësues të qitjes në rrobat dhe plagët e konstatuara atyre, por së pari nga eficienta e lartë e përdorimit të fishekëve për të qëlluar objektivin e synuar (ku nga totali prej 24 plumbash të shtënë, nga eksperti mjeko ligjor u konkludua se së paku 20 plumba kanë goditur dy viktimat). Duke marrë parasysh se një plumb tjetër ka qëlluar drejtpërdrejtë në tokë nga një distance vetëm disa centimetra (nga viktimja Gjergj Shotaj gjatë rrëzimit të tij), duke shkaktuar një krater në tokë afër tij dhe një tjetër ka goditur të pandehurin Ardjan Narkaj (pra 22 nga 24 plumbave të shtënë u është përcaktuar objekti i goditur) si dhe kushtet e errësisës në të cilat është zhvilluar ngjarja, çdo arsytim i kundërt për qitje nga një distancë mbi 1-1.5 metra do të rezultonte krejtësisht jologjik.

e. Në lidhje me gëzhjojat e gjetura në vendngjarje gjykata vlerëson se ato me numër (tabelë) 13, 14, 20, 21, 4 dhe 31 janë qitur nga pistoleta TT, ajo me numër 32 është qitur nga pushka 10.teshe dhe gëzhjojat e tjera model 56 janë qitur nga automatiku Zastava. Gjykata vëren se në vendimet përkatëse nuk është kërkuar dhe më pas për rrjedhojë as në aktet e ekspertimit balistike nuk është bërë përcaktimi i armëve të cilat i kanë shtënë gëzhjojat sipas numrit që atyre u është venë (në paketim) në vendngjarje (sipas tabelës së fiksimit në vendngjarje), por siç u citua nga përmbajtja e akteve, është dhënë vetëm përfundimi se sa prej këtyre gëzhjave janë qëlluar nga njëra armë dhe sa nga tjetra. Moskryerja si duhet i këtyre akteve vështirëson vetëm dallimin e 2 gëzhjave të qitura nga pushka 10\_teshe, nga 16 gëzhjojat e qitura nga automatiku Zastava, pasi gëzhjojat e qitura nga pistoleta TT janë lehtësisht të dallueshme për shkak se janë të një tjetër modeli. Megjithatë nisur nga fakti se njëra prej gëzhjave të kësaj pushke është gjetur në folenë e fishekut të kësaj arme, duke marrë për bazë pozicionin e

viktimës Tonin Ulaj (i cili ka qëlluar me këtë armë) gjykata krijon bindjen se gëzhoja tjetër (model 56) e qitur nga kjo armë është ajo me numër 32, pasi të gjitha gëzhojat e tjera në të djathtë të tij janë model 54. Gjithë gëzhojat e tjera model 56 janë qitur nga automatiku Zastava.

f. Viktima Tonin ka patur fillimisht në dorë vetëm pushkën 10.teshe pasi përdorimi i saj pamundësonte mbajtjen e një objekti tjetër në dorë, qoftë dhe armën pistoletë. Pushka 10. tëshe e modifikuar e mbajtur nga viktima Tonin, ka patur të hequr tubin e kthimit të gazrave dhe pistonin, pjesë të cilat shërbejnë për nxjerrjen e gëzhojës së fishekut të shtënë jashtë dhe me pas majën nga gusha dhe futjen në fole të fishekut të radhës. Duke qenë se tek kjo armë nuk funksiononte ky mekanizëm, nxjerrja e gëzhojës dhe futja e fishekut të ri duhej të bëhej manualisht nëpërmjet tërheqjes së shulit, përdorim i cili kërkon patjetër përdorimin e të dy duarve (e majta për të mbajtur armën dhe e djathta për të tërhequr shulin). Ndodhur para një vetëdije të tillë për mënyrën e funksionimit të saj dhe nisur nga fakti se nga aktet e ekspertimit është provuar se nga viktima Tonin është përdorur për të shtënë dy herë në kushte të tilla, Gjykata përjashton mundësinë që ky shtetas të ketë mbajtur në dorë njëkohësisht edhe armën pistoletë. Fakti që kjo armë është gjetur nën trupin e viktimës Gjergj Shotaj, provon se viktima Tonin ka shtënë fillimisht me të dhe me pas për shkak të vështirësisë së përdorimit të saj në kushte të tilla, e ka hedhur atë përtokë (dhe po menjëherë është zënë poshtë me trup nga viktima Gjergj, i cili po humbte fuqitë nga plumbat e asaj armë) dhe ka nxjerrë pistoletën TT (të cilën eventualisht duhet ta ketë patur në brez).

g. Të shtënat me armë (me pushkën 10. tëshe) nga viktima Tonin në drejtim të të pandehurit Ardian (i cili për shkak të goditjes me kokë nga viktima Gjergj ishte spostuar rreth 30 cm më pas) nuk kanë kapur atë, por viktimën tjetër Gjergj, i cili menjëherë duke u rrëzuar (për shkak të plagës së marrë) është përgjigjur duke shtënë në drejtim të Toninit dhe të Ardianit. Megjithëse viktima Gjergj është përpjekur ta tërheqë me vete gjatë rrëzimit të tij, i pandehuri Ardian është mbajtur në këmbë dhe nuk është rrëzuar bashkë me të.

h. Viktima Gjergj ka vazhduar të qellojë me armen automatik Zastava edhe pasi është rrëzuar përtokë dhe njeri nga plumbat ka goditur të pandehurin Ardian në këmbën e djathtë, sipër kavaljes. Nisur nga drejtimi i qitjes (i cili nga mjeku ligjor Dhori Toshi u tha se është pak nga poshtë lart dhe nga akti i ekspertimit kimik të rrobave të tij u përcaktua se ishte nga prapa-përpara) krijohet bindja se ky plumb është qëlluar nga arma automatik Zastava, pasi viktima Gjergj ishte rrëzuar përtokë dhe i pandehuri Ardian ishte liruar nga duart e tij dhe po përleshëj tashmë me viktimën Tonin. Nisur nga fakti i provuar se drejtimi i lëvizjes së predhës (ku vrima e hyrjes është vetëm 5 mm me poshtë se vrima e daljes), i cili është pothuajse horizontal, Gjykata përjashton mundësinë që kjo plagë të jetë shkaktuar nga të shtënat e viktimës Tonin, i cili në këtë kohë ka qenë në këmbë.

Në lidhje me kontradiktoritetin e drejtimin të qitjes të përcaktuar në aktin kimik të rrobave të të pandehurit Ardian me atë të dhënë nga mjeku ligjor Dhori Toshi (para Gjykatës), Gjykata vlerëson si më bindës dhe të nxjerre mbi argumenta shkencore më të besueshme të parin. Gjetja e faktorëve plotësues të qitjes në këto rroba (në çorapen e të pandehurit) në pjesën e pasme të këmbës jo vetëm që përjashton drejtimin e dhënë nga mjeku ligjor, por dhe konkluzionin tjetër të tij në lidhje me këtë plagë se qitja është jashtë faktorëve plotësues të qitjes. Nga ana tjetër siç u arsyetua më lart përfundimi i dhënë nga mjeku ligjor për drejtimin e qitjes nga para-prapa është i pamundur të realizohet në atë pjesë të trupit nga një distancë e afërt (jo më shumë se 1 metër) dhe nga një pozicion qitjeje në këmbë, në një kohë që përfundimi tjetër i qitjes nga pozicioni i rrëzuar nga prapa është plotësisht logjik...”

**Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 124, datë 20.06.2012 ka argumentuar se :**

“... Referuar përgjimeve ambientale të bëra mes të pandehurve Ardian Narkaj, Gjekë Narkaj, Ilir Therçaj, Gjelosh Narkaj provohen fakte se pas ngjarjes të pandehurit Ardian e Gjekë

Narkaj kanë rënë në marrëveshje mes tyre për të fshehur të vërtetën dhe provat materiale si janë pistoletat, automatiku edhe thika. Nga përgjimet ambientale provohet gjithashtu se i pandehuri Gjekë Narkaj, që në momentet e para e në vazhdim është munduar që të shmangë veten nga përgjegjësia penale, duke mos dhënë asnjë detaje rreth vrasjes dhe duke pretenduar se viktimat kanë vlarë njeri-tjetrin. Pavarësisht se deklarimet e tij, si dhe gjatë përgjimit ambiental, ai përpiqet të mohojë edhe veprimet që ka kryer për të fshehur armët e kimit, më pas ai pranon që ti ketë kryer ato veprime. Këto fakte si dhe deklarimet e të pandehurit Ardian, bazuar edhe në provat e marra gjatë gjykimit, e bëjnë të pabesueshëm të pandehurin Gjekë Narkaj në alibinë e tij.

Në këto rrethana, provohet se i pandehuri Ardjan Narkaj ka kryer vrasjen në bashkëpunim me një person tjetër dhe konkretisht me të pandehurin Gjekë Narkaj. Si rrjedhim, duke qenë bashkëpandehur në kryerjen e veprës penale të vrasjes, i pandehuri Gjekë Narkaj nuk mund të përgjigjet për veprën penale të “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” veprë qëparashikohet nga neni 301 i K. Penal.

Për këtë akuze, çështja penale në ngarkim të tij duhet të pushohet. Nga provat e administruara në këtë gjykim është provuar fajësia e të pandehurit Gjekë Narkaj lidhur me akuzën e parashikuar nga neni 278/2 i K. Penal.

Gjithashtu është provuar edhe fajësia e të pandehurit tjetër Ilir Therçaj lidhur me kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 301 e 278/2 i K. Penal.

Lidhur me konstatimin e gjykatës për të pandehurin Gjekë Narkaj si bashkëpandehur për kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasve Ton Ulaj dhe Gjergj Shotaj, i mbetet organit të hetimit të filloje ndjekjen penale për këtë të pandehur, pasi Gjykata e Apelit në zbatim të nenit 425/3 të K.Pr.Penale nuk mund të rëndojë pozitën e këtij të pandehuri, i cili që në fillim të hetimeve paraprake e në vazhdim është akuzuar vetëm për kryerjen e veprave penale të “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” dhe “Mbajtje pa leje të armëve luftarake”, vepra që parashikohen nga neni 301 e 278/2 i K. Penal dhe prokurori nuk është ankuar për këtë të pandehur.”.

#### **D. Në lidhje me rekursin.**

**Kundër këtij vendimi, më datë 12.07.2012 ka paraqitur rekurs i gjykuari Ardian Narkaj dhe ka kërkuar:**

“Prishjen e vendimit Nr. 124, datë 20.06.2012, të dhënë nga Gjykata e Apelit Shkodër, lënien në fuqi të vendimit Nr. 248, datë 27.04.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për pikat, 1, 3, 4, dhe 5 të këtij vendimi për të pandehurin Ardian Narkaj -Ndryshimin e pikës 2 të Vendimit Nr. 248 datë 27.04.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke e deklaruar të pafajshëm të pandehurin Ardian Narkaj për veprën penale të “Vrasjes në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” ndaj shtetasit Gjergj Shotaj.” duke parashtruar shkaqet e përmendura në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

#### **E. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes.**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e çmon rekursin e ushtruar ndaj Vendimit Nr. 124, datë 20.06.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër, të bazuar në nenin 432 (a) të Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi Nr. 124, datë 20.06.2012 i Gjykatës së Apelit Shkodër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, pasi nga ana e Gjykatës së Apelit nuk është bërë një analizë e plotë dhe e gjithanshme çështjes objekt shqyrtimi.

Vendimi i Gjykatës së Apelit, në raport me analizën lidhur me përgjegjësinë e të gjykuarit Ardian Narkaj rezultoi i paarsyetuar në të gjithë elementet e tij dhe provat e administruara në hetim dhe gjykimin në shkallë të parë.

Gjykata më së shumti është marrë me kontradiksione që lidhen me mundësinë e realizimit të vrasjes së viktimave vetëm nga i gjykuari Ardian apo në bashkëpunim me të tjerë duke hedhur idenë e bashkëpunimit të Gjekë Narkaj, por pa analizuar të gjitha provat në lidhje me anën objektive dhe subjektive të të gjykuarit Ardian Narkaj duke mos analizuar disa prej provave mjaft të rëndësishme të mara gjatë hetimit sikurse janë rezultatet e përgjimit ambiental.

Gjykata e Apelit, i analizon rezultatet e përgjimit vetëm për pjesën që lidhet me fshehjen e armëve, por nuk bën asnjë vlerësim në lidhje me rezultatet e përgjimeve që hedhin dritë mbi anën objektive të kryerjes së veprës penale, pra mënyrës si ka ndodhur ngjarja çka do të hidhte dritë dhe mbi anën subjektive të tij.

Po kështu mbeten të pa analizuar në raport me anën subjektive dhe qëndrimin që i gjykuari ka mbajtur në raport me ngjarjen, qëndrime këto të shprehura në përgjimin ambiental dhe që shprehin në mënyrë të pandikuar anën subjektive të tij.

Edhe pse gjatë hetimit e kryesisht në përgjimin mes Ardianit dhe Gjek Narkaj evidentohet një marrëveshje për të pasqyruar situatën sikur viktimat kanë vvarë njëri tjetrin, evidentohet se në përgjimet e tjera të të gjykuarit Ardian si dhe në deklaratimet e bëra nga ai në seancë gjyqësore kemi një situatë tjetër e cila nuk është analizuar nga Gjykata e Apelit.

Analiza e të gjitha provave të mara nga hetimi dhe gjykimi i procedimit është e detyrueshme nga gjykata dhe vetëm vlerësimi për secilën prej tyre në harmoni me provat e tjera krijon sigurinë për një vendimmarrje të drejtë.

Përveç mos analizimit të provave të mësipërme, vendimi i Gjykatës së Apelit paraqet dhe kontradiksione logjike mes arsyesive që bën dhe konkluzioneve që arrin e kjo në lidhje me përgjegjësinë e të gjykuarit Ardian Narkaj. Kështu në faqen 12 të vendimit argumentohet se “I pandehuri Ardian, i ndodhur në këto rrethana dhe i tmerruar se mund t’u vrisnin, pasi kishte marrë dhe një plagë në këmbë, ka marrë një thikë në xhepin e makinës dhe ka goditur Tonin Ulaj e pastaj ka marrë pistoletën e tij dhe ka qëlluar në drejtim të viktimave... Gjatë shkëmbimit të zjarrit, dy viktimat mbanin në mes të pandehurin Ardian për t’u mbrojtur nga plumbat që vinin në drejtim të tyre”, e më pas në faqen 16 të vendimit, Gjykata e Apelit konkludon se “Në përfundim, i pandehuri Ardian Narkaj duhet të deklarohet fajtor për veprën penale “Vrasje në rrethana cilësuese”, veprë që parashikohet nga neni 79/dh i K. Penal.”

Po kështu në vendimin e saj Gjykata e Apelit del në konkluzione absolutisht të papranueshme duke e bërë vendimin të cenueshëm në rastin kur këto konkluzione i arrin mbi bazë aludimesh sikurse është ajo e shkruar në faqen 15 të saj që shprehet se “Mungesa e këtyre faktorëve (faktorë plotësues në rroba e duar), nuk përjashton të pandehurin Gjekë Narkaj nga përgjegjësia penale për vrasjen e shtetasve Ton Ulaj dhe Gjergj Shotaj, pasi menjëherë pas ngjarjes, i pandehuri Gjekë ka shkruar në banesën e tij, duke patur të gjitha mundësitë për të larë duart dhe për të ndryshuar rrobat”.

Të gjitha sa u thanë më sipër e bëjnë vendimin e Gjykatës së Apelit të cenueshëm për pasojë ai duhet të priset dhe të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 441/ç të Kodit të Procedurës Penale,

### **V E N D O S I**

Prishjen e vendimit Nr. 124 datë 20.06.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 11.03.2015

**A N Ë T A R**

**Guxim ZENELAJ**

**A N Ë T A R**

**Ardian DVORANI**

**K R Y E S U E S**

**Edmond ISLAMAJ**

**A N Ë T A R**

**Artan ZENELI**

**A N Ë T A R**

**Admir THANZA**

Vertetohet njesia me origjinalin P/Z. Adm. Gjyq. D.Qerimi

M.D